

V E N D I M
Nr.84, datë 12.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 12.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.89 Akti që i përket:

KËRKUES: NDUE LAZER PJETRA, kandidat për deputet i Partisë Socialdemokrate, përfaqësuar me deklaram nga avokat Lazër Preng Zefi.

SUBJEKTE TE INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. PJETËR ARBNORI, kandidat për deputet, i pavarur, mbështetur nga PD+BF, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.988, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përsëritja e zgjedhjeve në 5 qendra votimi

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Në qendrën e votimit nr.9 Kosmaq të Komunës Bushat nuk janë bërë votimet dhe procesverbali është nënshkruar nga një person i vetëm, duke falsifikuar format e anëtarëve të tjerë të komisionit të qendrës së votimit.

- Në qendrën e votimit Stajka, 51 banorë të këtij fshati ndodhen jashtë shtetit dhe figurojnë se kanë votuar.

- Në qendrën e votimit Mjedë, 72 persona të regjistruar në këtë qendër votimit ndodhen jashtë shtetit dhe figurojnë në procesverbale se kanë votuar.

- Në qendrën e votimit Melgushe, 29 persona në qendrën e votimit të Komunës Vig Mnele, 13 persona dhe në qendrën e votimit Ashtë 17 persona ndodhen jashtë shtetit dhe figurojnë sikur kanë votuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Tefta Zaka, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.988, datë 29.6.2001, ka shpallur rezultatin në zonën zgjedhore nr.3, duke njohur si fitues kandidatin e pavarur për deputet, zotin Pjetër Arbnori.

Në tabelën përmbledhëse model 39/1 të rezultateve të zonës zgjedhore nr.3, kërkuesi figuron i katërti dhe me një diferencë prej 7 593 votash me subjektin e interesuar zotin Pjetër Arbnori, kandidat i pavarur për deputet i mbështetur nga koalicioni “Bashkimi për Fitore”.

Kërkuesi ka pretenduar se, në qendrën e votimit nr.9 Kosmaq, Komuna Bushat, nuk janë bërë

zgjedhje dhe procesverballi është nënshkruar nga një person i vetëm, duke falsifikuar nënshkrimet e anëtarëve të tjerë të komisionit. Sipas kërkesit, Komisioni i Zonës Zgjedhore e ka përfshirë këtë procesverbal në rezultatin përfundimtar.

Pretendimi i kërkesit nuk qëndron sepse në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve Model 39/1 është pasqyruar vërejtja e Kryetarit të Komisionit të Zonës Zgjedhore për këtë qendër votimi dhe Komisioni i Zonës Zgjedhore e ka pranuar, duke vendosur të mos përfshijë në rezultatet e tabelës përmbledhëse, procesverbalet e qendrës së votimit nr.9, Komuna Bushat, meqenëse ishin pa nënshkrimet e anëtarëve të komisionit të kësaj qendre votimi.

Pretendimi i kërkesit se kanë votuar banorë të cilët banojnë aktualisht jashtë shtetit, në qendrat e votimit në Stajkë, Mjedë, Melgushë, Vig Menelë dhe Ashtë, nuk u provua në seancë gjyqësore prej tij. Por, edhe po të ishte provuar, numri i personave të pretenduar është 180 dhe nuk ndikon në ndarjen e mandateve në Kuvend, kërkesë e nenit 113/a të Kodit Zgjedhor, për arsye se diferenca midis kërkesit dhe subjektit të interesuar është 7 593 vota.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se vendimi nr.988, datë 29.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “e” dhe 132 të Kushtetutës; nenet 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenin 140 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.